**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

# V E N D I M

Nr. 3, datë 15.01.2010

## PËR
## "LIDHJEN E KONTRATËS SË PRIVATIZIMIT, PËR BANESËN NR. 146, RRUGA "HOXHA TAHSIM", NË FAVOR TË QYTETARIT MEHMET SPAHIU, NË ZBATIM TË VENDIMIT TË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË TIRANËS NR. 4261, DATË 29.06.2005".

Bazuar në ligjin Nr.8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", neni 32 pika "e"; Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.97, datë 03.02.2008 "Për procedurat e privatizimit të banesave", objekt i Ligjit Nr.7652, datë 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore"; Dekretin e Presidentit të Republikës Nr.1440, date 04.04.1996 "Për trajtimin e banesave shtetërore të paprivatizuara"; Vendimin e formës së prerë të Gjykatës së Shkallës së Parë të Tiranës Nr.4261, datë 29.06.2005, i lënë në fuqi me Vendimin e Gjykatës së Apelit Nr. 932, datë 13.09.2006; Urdhërin e Zyrës së Përmbarimit, Tiranë Nr. 3395, datë 10.04.2007, me propozimin e një grupi këshilltarësh, Këshilli Bashkiak,

# V E N D O S I :

1. Të lidhet kontrata e privatizimit, për banesën e ndodhur në rrugën "Hoxha Tahsim" Nr. 146, sipas Vendimit të Gjykatës, në favor të qytetarit Mehmet Spahiu.

2. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë së Tiranës për lidhjen e kontratës së privatizimit.

3. Ngarkohet Ndërmarrja Nr.3 e Punëtorëve të Qytetit për përfundimin e procedurave.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

Sokol DERVISHAJ

**K R Y E T A R**